



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Mandate, Imunitete
dhe Rregullore të Punës
Mbledhja nr. 3
Prishtinë, me 8 korrik 2008
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

P R O C E S V E R B A L

**nga mbledhja e Komisionit për Mandate, Imunitete
dhe Rregullore të Punës**

Në mbledhje morën pjesë: Kolë Berisha, Hydajet Hyseni, Xhezair Murati, Fehmi Mujota,
Ramadan Gashi, Fatmire Berisha, Suzan Novoberdaliu dhe Ismet Beqiri.

Munguan: Besa Gaxherri, Radmilla Vujoviç.
Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit mori pjesë: Eshref Vishi
Nga Departamenti ligjor mori pjesë: Daut Beqiri, Drejtor i Departamentit

Nga zyra mbështetëse mori pjesë: Nur Çeku

Mbledhjen e kryesoi:
Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Shqyrtimi i Rregullores së re të Punës së Kuvendit
3. Rekomandim lidhur me kërkesën për heqjen e imunitetet të deputet z. Sabit
Rrahmani
4. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Rregullores së re të Punës së Kuvendit

Në lidhje me këtë, kryesuesi njoftoi se deri me tani kanë ardhur disa propozim-drafte të disa pjesëve të Rregullores së re të Punës, nga përgjegjësit të cilët janë caktuar më parë në mbledhjen e komisionit. Kanë ardhur propozimet nga OSBE-ja, nga anëtarja e komisionit zj.Suzana Novaberdeliu, z. Daut Beqiri Drejtor Ligjor dhe nga z. Kolë Berisha.

Ai ftoj të gjithë përgjegjësit të sjellin propozimet e tyre, deri me datën 20 korrik 2008, në mënyre që pastaj të mund të kemi një draft që të punojmë në punëtorinë që do të mbahet në Ohër, nën organizim të OSBE-së. Ju e dini që më parë ky udhëtim nuk u realizua dhe unë kam pasur një takim me ambasadorin e OSBE-së z. Tim Guldiman, i cili ka shprehur keqardhjen për këtë.

Për hollësitë e udhëtimit për Ohër, foli përfaqësuesi nga OSBE-ja z. Petrit Hysaj. Ai tha se tashme OSBE-ja ka paraparë të gjitha çështjet organizative dhe nga data 23- deri me 26 korrik do të qëndrohet në Ohër, ku komisioni bashkë me ekspert të tjerë, pritet të harmonizojnë draftin e Rregullores. Shpenzimet e akomodimit dhe qëndrimit do ti mbulojë organizatori.

Hydajet Hyseni- tha se do ishte mirë të shikohet mundësia që gjatë qëndrimit në Ohër, të shikohet mundësia e një takimi në Pogradec me komisionin homolog shqiptar që të kemi një shkëmbim përvoja në këtë drejtim. Lidhur me këtë ide, u vendos që të shikohet mundësi për mbajtjen e këtij takimi.

Kolë Berisha- tha se ka përfunduar pjesën e Rregullores për të cilën ka qenë përgjegjës dhe kjo do tu shpërndahet edhe anëtarëve të tjerë të komisionit.

3. Rekomandim lidhur me kërkesën për heqjen e imunitetit të deputet z.Sabit Rrahmani

Kryesuesi theksoi, se Komisionit ju ka adresuar një kërkesë për heqjen e imunitetit për deputetin Sabit Rrahmani. Në kemi përgatitur një draft-rekomandim, për diskutim në komision dhe nëse komisioni vendos, do t'ia procedojmë Kryesisë së Kuvendit. Në ndërkohe ka ardhur një letër nga vet deputeti Sabit Rrahmani.

Hydajet Hyseni tha, nuk duhet të ngutemi dhe duhet ti dëgjojmë edhe personalisht arsyetimet e vet Deputetit.

Ismet Beqiri theksoi, se deri në mbledhjen e ardhshme të pritet dhe të merret vendimi nga komisioni për dhënien e pëlqimit.

4. Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë nuk pati diskutime

Mbledhja përfundoi në orën 12.20.

Ahmet Isufi
Kryetar i Komisionit

Përgatiti:
Njësia mbështetëse e komisionit